

KONTRATË SHITBLERJE

(Kuotash në Kapitalin Themeltar)

E lidhur sot, më datë 24.08.2021 (dymijë e shtatëmbëdhjetë), mes palëve kontraktuese si më poshtë:

SHITËS: Z. Gafur Lleshi i biri i Haqif , i datelindjes 22.05.1967 lindur ne Dom,Mat , banues ne. Klos, me dokument indentifikimi nr personal G70522007K , me nr ID031389211 madhor, me zotësitë plotë juridike dhe për të vepruar,

BLERËS: Z. Jeton Hoti i biri i Idriz lindur më 09.06.1984 në Burrel_ dhe banues në Tirane , me dokument indentifikimi id nr 036569065 dhe nr personal I40609124P, madhor, me zotësitë plotë juridike dhe për të vepruar

Palët, me dëshirën dhe vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar, pasi kanë zhvilluar bisedime paraprake, në mbështetje të nenit 705 e vijues të Kodit Civil, Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar; Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", Vendimin e Asamblesë Nr prot: _____ datë 18.02.2021 Statutin e Shoqërisë ".Klosi Group." sh.p.k, ranë dakord të lidhin këtë Kontratë Shitblerjesh Kuotash me përmbajtjen si vijon:

1. TË DHËNA PARAPRAKE

1.1 Shitësi Z. Gafur Lleshi është ortak i Shoqërisë " Klosi Group " sh.p.k, shoqëri tregtare, identifikuar me Nr. NIPT (NIUS) L88516901I zotërues i 1 (nje) pjese që përbëjnë 35% (pesëmbëdhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar të kësaj Shoqërie.

2. OBJEKTI

2.1 Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi Gafur Lleshi) pjesën që përbëjnë 35% (tridhjetë e pese për qind) të kapitalit themeltar të regjistruar të Shoqërisë Klosi Group " sh.p.k, person juridik privat i së drejtës shqiptare, identifikuar me Nr. NIPT (NIUS) .L88516901I

2.2 Blerësi deklaron se pranon të blejë pjesët (kuotën) e kapitalit të Shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 2.1 të kësaj Kontrate.

2.3 Transferimi nëpërmjet shitblerjes do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe më veçanërisht me dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit Nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

3. ÇMIMI DHE MËNYRA E PAGESËS

3.1 Transferimi i pjesëve të kapitalit të shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 2.1 të kësaj Kontrate nga Shitësi tek Blerësi do të kryhet përkundrejt çmimit prej 35000 (tridhjetë e pese mijë) lekë ALL.

3.2 Palët deklaronë së çmimi i përcaktuar në nenin 2.1 të kësaj Kontrate është paguar tërësisht nga Blerësi në momentin e nënshkrimit të këtij akti. Palët, Shitësi dhe Blerësi nuk kanë asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm për çmimin e shitjes sipas kësaj Kontrate.

4. KALIMI I PRONËSISË

4.1 Pronësia mbi 1 (nje) pjesë që përbëjnë 35% (tridhjetë për qind) të kapitalit themeltar të regjistruar të Shoqërisë " **Klosi Group** " sh.p.k, do të kalojë nga pala shitëse, . Gafur Lleshi , tek pala blerëse Jeton Hoti në momentin e depozitimit të kësaj Kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, Tiranë.

4.2 Nga momenti i depozitimit të Kontratës në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pala shitëse, . Gafur Lleshi humbet çdo të drejtë pronësie mbi 35% (pesëmbëdhjetë për qind) të kapitalit themeltar të regjistruar të Shoqërisë ".**Klosi Group**" sh.p.k, dhe këto të drejta fitohen nga blerësi, i cili nga ky moment bëhet ortak i Shoqërisë " Klosi Group " sh.p.k, me strukturën e pjesëve si vijon:

Ortakët e Shoqërisë	Pjesët e Zotëruara	Përqindja e Kapitalit
Jeton Hoti	1	100%

4.3 Pala shitëse detyrohet:

- T'i kalojë palës blerëse pronësinë mbi pjesët objekt i kësaj kontrate të lirë nga çdo barrë, sekuestrim dhe detyrime të çfarëdolloj natyre.
- T'i dorëzojë palës blerëse dokumentacionin mbi pronësisë e kuotave që i shet nëpërmjet kësaj kontrate.
- Të paguajë shpenzimet e regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

5. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

5.1 Për këtë Kontratë, do të jenë bazë për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë,
- Legjislacioni që rregullon organizimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare;
- Aktet e tjera ligjore që nuk bien në kundërshtim me këtë kontratë.

5.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të shfaqen midis palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin, ekzekutimin, zgjidhjen apo vlefshmërinë e kësaj Kontrate, do të zgjidhen me mirëkuptim mes tyre, në rast të kundërt organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. DISPOZITA TË FUNDIT

6.1 Administratori i Shoqërisë ". Klosi Group." sh.p.k, është i detyruar të bëjë ndryshimet përkatëse në regjistrin themeltar të kuotave.

6.2 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe brenda qëllimit që i bëri Palët të nënshkruajnë këtë Kontratë.

6.3 Kontrata u përpilua në 4 (katër) kopje me fuqi të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe, nga një kopje marrin palët, një kopje depozitohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), dhe një kopje duhet të depozitohet në selinë e Shoqërisë.

Kontrata, pasi u lexua nga Palët, të vetëdijsëm se përmbajtja e saj është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, e nënshkruajnë atë pa vese.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËS

Gafur Lleshi



BLERËS

Jeton HOTI

